



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Selenicë,
“Mbi verifikimin e situatës pas rrëshqitjeve në rrugën Matogjin – Bashaj”**

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**(Auditim Tematik mbi verifikimin e situatës pas rrëshqitjeve në
rrugën Matogjin - Bashaj)**

BASHKIA SELENICË

Tiranë, mars 2026

PËRMBAJTJA

I. Përmbledhje.....	4
II. Hyrje.....	4
III. Qëllimi dhe procesi i auditimit	5
IV. Risku i rrëshqitjes së tokës.....	5
V. Dispozitat ligjore për çeljen e fondeve për Emergjencat Civile.....	7
VI. Rezultatet e auditimit	8
VII. Gjetje rekomandime	12

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër

Auditimi është kryer në bazë të autorizimit me nr. 53 prot., datë 12.01.2026, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për verifikimin e situatës pas rrëshqitjeve në rrugën Matogjin - Bashaj, Bashkia Selenicë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) verifikoi situatën pas rrëshqitjeve në rrugën Matogjin - Bashaj, Bashkia Selenicë.

Verifikimi i situatës sipas Autorizimit, u bë në Bashkinë Selenicë, lidhur me rrëshqitjet e ndodhura në segmentin rrugor Kthesa e Velçës – Vërmik, km 16+000 dhe 16+800 dhe masat e marra nga kjo bashki për përmirësimin e situatës dhe mbështetjen e banorëve të kësaj zone.

Nga auditimi i kryer dhe verifikimet në terren u evidentua se situata e krijuar pas rrëshqitjeve në segmentin rrugor Kthesa e Velçës – Vërmik, në zonën e fshatrave Bashaj dhe Matogjin, ka bërë që ky segment rrugor të jetë i pakalueshëm, duke izoluar banorët e zonës dhe penguar qarkullimin normal. Nga Bashkia Selenicë nuk rezultoi të jenë ndërmarrë procedura për mbështetje financiare ose materiale për familjet e prekura në fshatin Bashaj.

Gjithashtu, auditimi evidentoi mangësi në planifikimin strategjik, në hartimin e dokumenteve kryesore planifikuese dhe në vlerësimin teknik të problematikave gjeologjike, si dhe në planifikimin e investimeve për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e këtij segmenti rrugor, ku ndërhyrjet dhe fondet e planifikuara rezultojnë të pamjaftueshme.

Në këto kushte, është e nevojshme që Bashkia Selenicë të ndërmarrë masa të menjëhershme për përmirësimin e situatës infrastrukturore, për mbështetjen e banorëve të izoluar dhe për forcimin e planifikimit dhe koordinimit institucional në përdorimin e fondeve publike për menaxhimin e riskut dhe garantimin e aksesit normal në zonë.

b. Qëllimi dhe procesi i auditimit

-Audituesit e KLSH, kanë bërë verifikimin në vend të situatës, kanë kërkuar informacion nga Bashkia Selenicë për investimet apo mirëmbajtjen e këtij segmenti rrugor, si dhe për masat e marra nga kjo bashki për përmirësimin e gjendjes dhe për mbështetjen financiare/materiale për banorët e bllokuar të kësaj zone.

c. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucionet për periudhën nën auditim paraqesin të meta dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 5 gjetje dhe ka dhënë 5 rekomandime të karakterit organizativ.

II. Hyrja:

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të autorizimit me nr. 53 prot., datë 12.01.2026, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 12.01.2026 deri në datën 16.01.2026 u krye Auditimi Tematik “Për verifikimin e situatës pas rrëshqitjeve në rrugën Matogjin - Bashaj, Bashkia Selenicë”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. G. K., Kryeauditues
2. A.Z., auditues
3. L.Z., auditues
4. A.V., auditues

Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt verifikimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator.

Baza ligjore për menaxhimin e rrëshqitjeve:

- Ligj Nr. 103/2014, datë 31.07.2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë” ;
- Ligj Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” (2019);
- Ligji Nr. 154/2014, datë 27.12.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”;
- VKM nr. 168, datë 24.03.2023 “Për miratimin e vlerësimit të Riskut nga fatkeqësitë në nivelin qendror;
- Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, 2022-2025;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Dokumentimi i auditimit:

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur kundërshti për Projekt Raportin dhe është vijuar me hartimin e Raportit Përfundimtar i Auditimit.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Pozicioni gjeografik i kësaj krahine është i vështirë dhe i brishtë – i përbërë nga male të lartë, kodra, lugina të ngushta e shpate të thikta. Rruga aktuale, ku pjesa më e madhe është kalldrëm i dëmtuar, është pothuajse e pakalueshme gjatë dimrit dhe shumë e vështirë për automjetet edhe gjatë muajve të thatë. Ndërpërja e rrugës mund të sjellë izolim të plotë social, ekonomik dhe infrastrukturor.

Rruga Matogjin – Bashaj është pjesë e segmentit rrugor Varri i Tavos (rreth km. 24 të aksit Rrugor Vlorë- Kuç) – fshati Vërmik, me gjatësi 25 km.

Ky segment rrugor lidh aksin kryesor Vlorë – Qeparo me fshatrat Velçë, Hysaj, Verbas, Ramice, Matogjin, Bashaj dhe Vërmik. Popullsia e regjistruar e kësaj zone është rreth 2000 banorë, nga të cilët jetojnë rreth 800 banorë (rreth 270 familje).

Për rehabilitimin e këtij segmenti rrugor nga Bashkia Selenicë është prokuruar një fond prej 119,120,027 mln lekë me TVSH dhe është lidhur kontrata “Sistemim Asfaltim “Rruga e Shullerit” me vlerë 111,253,611 lekë me TVSH, në zbatim të së cilës do të bëhet rikualifikimi i një segmenti rrugor “Varri i Tavos – Ura e Turbullit (Asomat)” me gjatësi 3.5 km.

Ky segment rrugor në përgjithësi karakterizohet nga prania e ujërave, pasi ka përrrenj aktivë në të gjithë zonën, si ai i Turbullit, i Vajzës, Ramicës, përroi ndërmjet fshatrave Matogjin dhe Bashaj, etj. Aktualisht këta përrrenj dhe të tjerë më të vegjël, të aktivizuar pas rreshjeve të datave 08.01.2026-09.01.2026, kanë prurje shumë më të mëdha se ato të zakonshmet.

Zona që përshkruhet nga kjo rrugë, ka premisa për zhvillim turistik pasi në këtë zonë gjenden:

- **Shpella e Shkruar e Velçës**, një monument natyre me vlera të veçanta historike e kulturore, ku ka nisur të vizitohet nga turistë vendas dhe të huaj, monument Kulture, kategoria I;

- **Kalaja e Boderit**- nje shpellë me dy kate, e formuar në shkëmbinj gëlqeror, fshati Bashaj.

- **Ujëvara e Rasalit**, një bukuri e rrallë natyrore e cila tashmë është bërë një destinacion turistik për turistët e huaj;

- **Tempulli i Asomatit**

- **Burimet termale në Vermik**, me cilësi dhe potencial për zhvillim turizmi shëndetësor;

- **Parku pyjor i malit të Çipinit**, një mjedis natyror i virgjër me mundësi për zhvillim të qëndrueshëm ekoturizmi;

- **Varret e korit te Mecit**- Varr i gdhendur në gur 2400 vjet para Krishtit.

- Rrëshqitjet, objekt i këtij auditimi, kanë ndodhur në datën 09.01.2026 në dy pika të segmentit rrugor Varri i Tavos – fshati Vermik dhe konkretisht në afërsi të km 16+000 (rrëshqitja nr. 1), fshati Matogjin dhe në km 16+800 (rrëshqitja nr. 2), fshati Bashaj i vjetër.

- Rrëshqitja e fshatit Matogjin është me gjerësi më të madhe se 250 ml, me një cedim të rrugës më shumë se 2 m dhe një gjatësi rreth 100 m mbi rrugë dhe 200 m nën rrugë. Nga vëzhgimi në vend (foto bashkëlidhur këtij Projektraporti), rezulton se rrafshi i rrëshqitjes mbi rrugë (Zona 1 në foto), përfshin edhe një pjesë shkëmbore, një pjesë e vogël e së cilës është shkëputur (Zona 2 në foto) dhe rënë në rrugë, ndërsa pjesa tjetër (Zona 3 në foto) është një rrezik i mundshëm për të rënë nga ndonjë lëvizje tektonike apo kushtet klimaterike. Në pjesën e poshtme të rrugës, formacioni i tokës është i butë dhe në fund të rrëshqitjes është lëngëzuar, duke përshpejtuar avancimin e rrëshqitjes

- Rrëshqitja e dytë (fshati Bashaj i vjetër), ka bërë këputjen e rrugës me gjatësi më të madhe se 80 ml. Në këtë segment, rruga është bërë e pakalueshme edhe për këmbësorët. **Nga ana e banorëve është bërë me mjete dore një rrugë për këmbësorë, e cila është shumë e vështirë dhe e rrezikshme për kalimin e tyre.** Ndërprerje e rrugës ka lënë të izoluar rreth 60 familje të fshatit Bashaj, ose rreth 200 banorë, duke u hequr të drejtën e lëvizjes për arsye jetike dhe frekuentimin e shkollës nga fëmijët e fshatit Matogjin në fshatin Bashaj. Formacioni i tokës në këtë rrëshqitje është argjilor dhe material shkëmbor i thërrmuar, i krijuar nga erozioni ndër vite. Ky formacion në dukje është i paqëndrueshëm dhe në fund të rrafshit të rrëshqitjes është lëngëzuar, duke përshpejtuar avancimin e rrëshqitjes (foto).

IV. Risku i rrëshqitjes së tokës

Për parandalimin, përbalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore në Republikën e Shqipërisë janë hartuar tre dokumente strategjike në nivel qendror, konkretisht: Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë; Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë si dhe Plani Kombëtar për Emergjencat Civile, të cilat janë miratuar respektivisht me VKM-në nr. 168, datë 24.03.2023, “Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror”, VKM-në nr. 94, datë 22.03.2023, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë 2023-2030 dhe planet e veprimtimit” dhe VKM nr. 807, datë 28.12.2023, “Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile”. Në këto dokumente evidentohet edhe ekspozimi ndaj risqeve lidhur me emergjencat civile për Qarkun e Vlorës në të cilën përfshihet edhe Bashkia e Vlorës.


Në zbatim të tre dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” i ndryshuar, në pikat 1-2, evidentohen angazhimet dhe detyrat që kanë institucionet e njësisive të vetëqeverisjes vendore për përfitimin e fondeve me qëllim reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile konkretisht:

“1. Bashkitë, për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, të përfitojnë nga buxheti qendror një fond të kushtëzuar për mbrojtjen civile.

2. Kriteret e përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, duhet të bazohen në:


- a) Strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;
- b) Vlerësimin vendor të riskut;
- c) Planin vendor të emergjencave civile;
- d) Planin e zhvillimit urban”.

Vlerësimi i riskut nga rrëshqitjet e tokës në qarqet e Shqipërisë është paraqitur më poshtë:



Risku më i lartë nga rrëshqitjet e tokës është regjistruar në qarqet Elbasan dhe Vlorë.

Qarku Vlorë



Qarku bregdetar i Vlorës është një nga qarqet me nivel të lartë të riskut të fatkeqësive. Përmbytjet dhe risqet teknologjike janë në nivele shumë të larta, të pasuara nga tërmetet dhe rrëshqitjet e tokës. Burimi kryesor i riskut teknologjik lidhet me funksionet e terminalit bregdetar të naftës “Vlora 1”. Skenarët e mundshëm të riskut kompleks dhe me efekte zinxhir mund të përfshijnë përmbytjet dhe/ose tërmetet që shkaktojnë aksidente të rënda teknologjike dhe çrregullime të shërbimeve kryesore. Probabiliteti i këtij skenari është mesatar në të lartë ndërsa ndikimi i mundshëm mund të jetë shumë i lartë, duke përfshirë ndikimin në ekosistem.

V. Dispozitat ligjore për çeljen e fondeve për Emergjencat Civile:

Për zvogëlimin e riskut, parandalimin, përbalimin, funksionimin dhe dhënien e shërbimit nga Drejtoria e MZSH-së dhe Emergjencat Civile në rastet e fatkeqësive natyrore si dhe për shpërbimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, financimi i Bashkive të Republikës së Shqipërisë realizohet nëpërmjet tre lloj burimesh konkretisht:

- Fondet nga Buxheti i Shtetit të cilat shpërndahen në formën e Transfertës së Kushtëzuar nëpërmjet ligjit vjetor të buxhetit të shtetit:

✓ Për vitin 2025:

Në zbatim të Ligjit nr. 97/2023, datë 07.12.2023, “Për buxhetin e vitit 2025”, neni 15, pika 6-9, dhe shkresën nr. 492/1 prot., datë 25.02.2025, të AKMC-së administruar në Bashkinë Selenicë me praktikën nr. 486 prot., datë 27.02.2025, fondi i akorduar në Programin “Emergjencat Civile” të MM-së i cili do të shpërndahet për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga MM-ja në bashkëpunim me MFE-në, ka përllogaritur për Bashkinë Selenicë peshën specifike në masën 0.66 % në vlerën **5,316,186 lekë**. Për vitin 2025 në degën e thesarit për Artikullin 604, janë funksional dy kode si më poshtë vijon:

1. Kodi i produktit 91707AG – “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve”.

2. Kodii produktit 91707AB- “Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”, Per sa më sipër, me qëllim përdorimin e fondit të kushtëzuar në kuadër të reduktimit

të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, kërkojmë nga ana juaj ndarjen e masës që do të përdoret sipas fondit në dispozicion.

Nëpërmjet kësaj korrespondence MM-ja i kërkon Bashkisë Vlorë që brenda datës 28.02.2025, me qëllim përdorimin e fondit të kushtëzuar në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, të kryej ndarjen e masës që do të përdoret sipas fondit në dispozicion. Me shkresën nr. 486/1 prot., datë 28.02.2025, Bashkia Selenicë i ka kthyer përgjigje Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, fondet do të përdoren për Kodin e Produktit 91707AG në vlerën **5,316,186.42 lekë**.

- VKB-ja nr. 58, datë 27.11.2026, “Për një shtesë në VKB nr. 54, datë 26.12.2024 Për buxhetin e bashkisë për vitin 2025” i ndryshuar “Për shpërblimin e punonjësve të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025 dhe përdorimin e fondit të emergjencës të alokuara për vitin 2025”, konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë mbi bazueshmërinë ligjore me shkresën nr. 1143/1 prot., datë 05.12.2025;

a) Fondi prej 5.316.186 lekë llog(604) kodi projektit 91707AG të përdoret për përmirësimin e banesave ekzistuese të varfra dhe të pafavorizuara.

VI. Rezultatet e auditimit, paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi është konstatuar se pas fshatit Bashaj i Vjetër, rreth 200 m nga rrëshqitja e dytë, ka ndodhur një tjetër rrëshqitje në vitin 2021, e cila është stabilizuar provizorisht me punime të pastuduara, me mjetet dhe fondet e Bashkisë Selenicë. Edhe pse dihet që kjo zonë ka historik të rrëshqitjeve ndër vite, nga ana e Bashkisë Selenicë nuk është marrë ndonjë masë parandaluese apo kërkesë në institucionet përgjegjëse për studimin gjeologjik të zonës, pasi, nisur nga “Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, 2022-2025”, Institucioni i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në lidhje me dukuritë negative gjeodinamike, zotëron një bazë të fuqishme të dhënash duke kryer një numër të madh studimesh me produktet përfundimtare.





Ndërmjet këtyre dy rrëshqitjeve të ndodhura në fshatin Bashaj (ajo e para 5 vjetëve dhe asaj aktive) gjenden 5 shtëpi banimi, familjet pronarë të të cilave akoma nuk janë evkuuar, edhe pse nga komunikimet e bëra nëpërmjet ehatsapp-it me Komisionin e Mbrojtjes Civile, Qarku Vlorë, Bashkia Selenicë ka njoftuar se shtëpitë janë 50 m larg rrëshqitjeve dhe kanë kërkuar ndihmën e policisë për të larguar banorët nga ndërtesat e afërta me rrëshqitjen.

Nga takimi i bërë në fshatin Bashaj me banorët e këtij fshati, grupi i auditimit konstatoi se kërkesat e tyre janë për sistemimin e kësaj rrëshqitje duke hapur një rrugë provizore pranë saj, pasi gjatësia e rrugës ndërmjet dy shkarjeve është rreth 800 m, ndërkohë rrugët e tjera të mundshme alternative janë 5-6 km më shumë dhe kohë shumë e gjatë për përshkrimin e tyre, për shkak të vështirësisë që ka terreni ku do të kalojnë rrugët alternative.

- Nga ana e Bashkisë Selenicë, është hartuar Urdhër Administrativ me nr. 6 prot., datë 05.01.2026 “Mbi krijimin e komisionit të planifikimit të emergjencave civile në Bashkinë Selenicë dhe Njësitë Administrative dhe grupet vullnetare të çdo njësie administrative”.

- Është hartuar Urdhri Nr. 8 i Kryetarit të Bashkisë, me nr. 72 prot., datë 12.01.2026 “Për ngritjen e komisionit të konstatimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore për vitin kalendarik 2026”, si dhe Urdhri Nr. 9 i Kryetarit të Bashkisë, me nr. 73 prot., datë 12.01.2026 “Për ngritjen e

komisionit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore për vitin kalendarik 2026”.

Bashkia Selenicë nuk ka ngritur asnjë grup pune dhe nuk është bërë asnjë plan veprimi konkret për menaxhimin e situatës së krijuar nga rrëshqitjet e datës 09.01.2026 në fshatrat Matogjin dhe Bashaj.

- Nga ana e Bashkisë Selenicë, është komunikuar me Prefektin e Qarkut Vlorë nëpërmjet emailit në datën 10.01.2026, ku i raportohet në lidhje me situatën e krijuar pas rrëshqitjeve në fshatrat Matogjin dhe Bashaj, konkluzionet e nxjerra së bashku me specialistët e Forcave të Armatosura, për zgjidhjen e problemit me hapjen e rrugës alternative Matogjin – lumë – Bashaj, rreth 6 km, si dhe nevojën për mjete fadromë dhe mjete vetëshkarkuese. Pas këtij emaili, Prefekti i Qarkut Vlorë, znj. E. A., me shkresën nr. 45/1, datë 10.01.2026, i ka kërkuar Ministrisë së Mbrojtjes Mbështetje me mjete të FA për Bashkinë Selenicë, për hapjen e rrugës alternative dhe shtrimin e një shtresë çakulli 20 cm. Pas kësaj kërkesë, Forcat e armatosura, me disa mjete (dy kamionë vetëshkarkues, dy ekskavatorë dhe një rul) kanë filluar hapjen dhe po vazhdojnë punën për sistemimin e rrugës alternative të ndërtuar vite më parë nga forcat e ushtrisë Matogjin – lumë – Bashaj, rreth 6 km, për lidhjen e këtyre fshatrave.





- Nga Bashkia Selenicë në muajin Shtator 2025, për mirëmbajtjen e rrugës Ramicë – Bashaj, me gjatësi 4370 ml, është hartuar një situacion nga z. K.S. nga Drejtoria e Shërbimeve, znj. D.N. nga Drejtoria e Financës dhe z. K.B. nga Drejtoria e urbanistikës (aprovuar nga zv. Kryetari i Bashkisë z. A.H.), sipas të cilit është realizuar një shtresë çakulli me $t=10$ cm në sasinë 3400 m^2 , si dhe nivelimi i rrugës me kovë me ekskavator me zinxhir në sasinë 4000 m^2 . Në bazë të këtyre zërave është përcaktuar edhe sasia e karburantit të harxhuar nga mjetet e bashkisë për këtë qëllim në sasinë 619 litra, ose 98,545 lekë ($619\text{ lit} \times 159.2\text{ lekë/lit}$), ose rreth 4000 lekë/km. *Pra, shpenzimet e bashkisë për mirëmbajtjen e kësaj rruge prej 25 km, në një vit kalendarik është bërë me fondet operative të bashkisë, në një vlerë të papërfillshme.*

- Nga komunikimi me përgjegjës të emergjencave civile të Bashkisë Selenicë, rezulton se nuk është bërë dhe as nuk ka filluar ndonjë procedurë për mbështetjen financiare/materiale të familjeve të izoluara në fshatin Bashaj.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se për rehabilitimin e këtij segmenti rrugor nga Bashkia Selenicë është prokuruar një fond prej 119,120,027 lekë me TVSH dhe është lidhur kontrata “Sistemim Asfaltim “Rruga e Shullerit” me vlerë 111,253,611 lekë me TVSH, në zbatim të së cilës parashikohet rikualifikimi i segmentit rrugor “Varri i Tavos – Ura e Turbullit (Asomat)” me gjatësi 3.5 km, nga 25 km që është segmenti rrugor Kthesa e Velçës (varri i Tavos) - Vërmik. Ky investim është i pamjaftueshëm, pasi pjesa e mbetur e këtij segmenti rrugor, rreth 21.5 km është shumë e amortizuar dhe në Bashkinë Selenicë nuk ka vijuar komunikimi me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për vazhdimin e këtij investimi dhe përfundimin e të gjithë këtij aksi rrugor, që do të zgjidhë përfundimisht lidhjen me rrugë të këtyre fshatrave dhe do të sjellë zhvillimin turistik të zonës.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitet 2024-2025, nga Bashkia Selenicë nuk janë marrë masat e duhura për hartimin e katër dokumenteve në nivel vendor konkretisht: Strategjinë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë; Vlerësimin Vendor të Riskut; Planin Vendor të Emergjencave Civile dhe Planin e Zhvillimit Urban, të cilat janë dokumente orientuese që shërbejnë për përdorimin e fondeve të akorduara nga buxheti qendror në formën e transfertës së kushtëzuar me qëllim zvogëlimin e riskut, parandalimin, përballimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” i ndryshuar, në pikat 1-2. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 5-6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Bashkia Selenicë, me anë të strukturave të ngritura për menaxhimin e risqeve dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik, të marrë masa për hartimin e strategjisë vendore për zvogëlimin e riskut, me qëllim marrjen e masave parandaluese për ti bërë ballë ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pas fshatit Bashaj i vjetër, rreth 200 m nga rrëshqitja në km 16+800, ka ndodhur një rrëshqitje tjetër në vitin 2021, e cila është stabilizuar vetëm provizorisht me punime të pastuduara, duke përdorur mjetet dhe fondet e Bashkisë Selenicë. Pavarësisht historikut të njohur të rrëshqitjeve në këtë zonë, Bashkia Selenicë, në kuadër të “Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2022–2025”, nuk ka ndërmarrë hapa për të kërkuar nga institucionet përgjegjëse, konkretisht nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, realizimin e një studimi të detajuar gjeologjik mbi dukuritë negative gjeodinamike, duke mos shfrytëzuar kështu të dhënat dhe ekspertizën e disponueshme nga institucionet kompetente. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 7-9. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Selenicë të marrë masa të menjëhershme duke kërkuar nga Shërbimi Gjeologjik Shtetëror, një studim kompleks gjeologjik – inxhinjër të gjithë zonës, e cila ka një historik rrëshqitjesh në vite, me qëllim ndërhyrjen me projekte konkrete për parandalimin e fenomeneve të rrëshqitjes në këtë zonë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për rehabilitimin e këtij segmenti rrugor nga Bashkia Selenicë është prokuruar një fond prej 119,120,027 lekë me TVSH dhe është lidhur kontrata “Sistemim Asfaltim “Rruga e Shullerit” me vlerë 111,253,611 lekë me TVSH, në zbatim të së cilës parashikohet rikualifikimi i segmentit rrugor “Varri i Tavos – Ura e Turbullit (Asomat)” me gjatësi 3.5 km, pjesë e segmentit total prej rreth 25 km nga “Kthesa e Velçës (Varri i Tavos) – Vermik. Megjithatë, ky investim rezultoi i pamjaftueshëm në raport me gjendjen e përgjithshme të aksit rrugor, pasi pjesa e mbetur prej rreth 21.5 km paraqitet në gjendje shumë të amortizuara dhe kërkon ndërhyrje rehabilituese. *(Më hollësisht trajtuar në faqen 12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Bashkia Selenicë të marrë të gjitha masat administrative, në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për hartimin e projektit për rehabilitimin e të gjithë këtij segmenti rrugor, pasi përfundimi i këtij objekti do të zgjidhë përfundimisht lidhjen me rrugë të këtyre fshatrave dhe do të sjellë zhvillimin turistik të zonës, në të cilën ndodhen objekte me vlera të veçanta historike dhe kulturore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për realizimin e lidhjes së fshatit Bashaj me rrugën ekzistuese, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë ndërhyrë me disa mjete (dy kamionë vetëshkarkues, dy ekskavatorë dhe një rul), duke filluar punimet për sistemimin e rrugës alternative të ndërtuar më parë nga Forcat e Ushtrisë Matogjin – Lumë – Bashaj, me gjatësi rreth 6 km. Deri në përfundim të fazës së auditimit në terren, lidhja e përkohshme e fshatit Bashaj me rrugën automobilistike nuk ishte arritur. *(Më hollësisht trajtuar në faqen 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Bashkia Selenicë të marrë të gjitha masat administrative, në bashkëpunim me institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë, për ndjekjen deri në përfundim të këtij segmenti rrugor alternativ, me qëllim që t’u krijojë mundësinë banorëve të zonës për lëvizjen normale për arsye jetike, si dhe frekuentimin e shkollës Bashaj nga nxënësit e fshatit Matogjin.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për mirëmbajtjen e aksit rrugor “Kthesa e Velçës (Varri i Tavos) – Vermik me gjatësi 25 km, në vitin 2025, me mjetet dhe fuqinë punëtore të bashkisë janë planifikuar fonde në vlerën 98,545 lekë gjithsej, ose 4,000 lekë/km, të cilat janë të pamjaftueshme për mirëmbajtjen e tij, duke bërë që ky segment rrugor të jetë i pakalueshëm për mjetet e ulëta dhe i vështirë për mjetet e tjera. *(Më hollësisht trajtuar në faqen 11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Bashkia Selenicë dhe Këshilli Bashkiak, të marrin të gjitha masat, që në planifikimin vjetor të fondeve, të bëjnë detajimin e fondeve operative, ku ky segment rrugor të ketë fonde të mjaftueshme, në mënyrë që të sigurojë një qarkullim normal të mjeteve.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT